

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
Janar 2025

Nr.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	10.01.2025	Pershendetje, Ne kuader te te drejtes per informim, do tju lutesha te na vinit ne dispozicion disa te dhena mbi baze te pyetjeve te meposhtme. 1) Sa eshte numri i aplikimeve te bashkive per kompensim te fermereve nga demet e shkaktuara nga fatkeqesite natyrore? 1.a) Sa prej tyre jane demshperblyer nga AKMC dhe sa jane ne proces pritje? 1.b) Sa eshte shuma per secilen bashki te shpenzuar nga AKMC? 2) Kur eshte hera e fundit qe eshte shpallur gjendja e jashtezakonshme per kompensimin e demeve ne bujqesi, sipas nenit ne fuqi ? 2.a) Sa fermere kane perfituar? 3) Cilat jane ngercet ligjore per ligjin per te drejten e kompensimit, duke nisur nga bashkite, te AKMC, e deri te ministrite perkatese? A eshte sot i zbatueshem ne praktike ky ligj? 4) Keni propozuar ndryshime ne ligjin per te drejten e kompensimit? Duke qene se	15.01.2025	Pershendetje z. Pire, Ju falënderojmë për interesimjn. Duke iu referuar pyetjeve tuaja dhe bazuar në kuadrin ligjor aktual, ju informojmë si më poshtë: 1) Sa është numri i aplikimeve të bashkive për kompensim të fermerëve nga dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore? • Bazuar në ligjin nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", që nga janari 2020, kompensimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore realizohet nga njësitë e qeverisjes vendore në territorin e të cilave ka ndodhur fatkeqësia. Të dhënat mbi numrin e	E plote	Nuk

		AKMC nderhyne vetem ne rastet e gjendjes se jashtezakonshme? Falemidnerit e pune te mbare!	aplikimeve dhe kompensimeve ndodhen pranë bashkive përkatëse. 1.a) Sa prej tyre janë dëmshpërblyer nga AKMC dhe sa janë në proces pritje? • Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) ka shlyer vetëm detyrimet e mbartura deri në dhjetor 2019, të reflektuara me aktin normativ përkatës. Pas kësaj periudhe, përgjegjësia për kompensimin i përket bashkive, bazuar në nenin 41 të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara		
--	--	--	---	--	--

			nga veprimtaria njerëzore.”		
			1.b) Sa është shuma për secilën bashki të shpenzuar nga AKMC? • Të dhënat mbi shumat specifike për secilën bashki ndodhen pranë njësive të qeverisjes vendore, pasi AKMC ka ndërprerë kompensimet pas shlyerjes së detyrimeve të mbartura deri në dhjetor 2019.		
			2) Kur është hera e fundit që është shpallur gjendja e jashtëzakonshme për kompensimin e dëmeve në bujqësi, sipas nenit në fuqi? • Gjatë periudhës që nga ngritja dhe funksionimi i AKMC-së, nuk është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore për dëme në bujqësi.		
			2.a) Sa fermerë kanë përfituar?		

			• Numri i fermerëve përfitues duhet të kërkohet pranë bashkive përkatëse, të cilat ndjekin procedurat e përcaktuara në nenin 41 të ligjit nr. 45/2019 dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.05.2012.		
			3) Cilat janë ngrerçet ligjore për ligjin për të drejtën e kompensimit, duke nisur nga bashkitë, AKMC dhe deri te ministritë përkatëse? A është sot i zbatueshëm në praktikë ky ligj? • Kuadri ligjor është i plotë dhe funksional. Ligji nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" përcakton procedurat për konstatimin dhe vlerësimin e dëmeve, si dhe autoritetet përgjegjëse për çdo hap. • Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.05.2012, detajon kriteret		

			dhe dokumentacionin e nevojshëm për procesin e kompensimit. • Aktualisht, zbatimi praktik i ligjit mund të hasë sfida në nivel lokal për shkak të kapaciteteve administrative të bashkive, por ligji është i zbatueshëm. 4) Keni propozuar ndryshime në ligjin për të drejtën e kompensimit? Duke qenë se AKMC ndërhyr vetëm në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme? • Aktualisht, është hartuar një draft i ri i Vendimit të Këshillit të Ministrave, i cili synon të përmirësojë më tej procesin e kompensimit. Ky draft pritet të miratohet së shpejti. Jemi në dispozicion për çdo sqarim apo informacion shtesë.		
--	--	--	---	--	--

2	15.01.2025	Përsëndetje! Uroj të jeni mirë! Jam D H, gazetarë në redaksinë e lajmeve në tv Klan. Kërkojmë të kemi një intervistë në lidhje me satelitët "Albania 1" dhe "Albania 2". Pyetjet si më poshtë: Që nga koha kur janë lëshuar në hapësirë satelitët "Albania 1" dhe "Albania 2", sa imazhe janë prodhuar dhe konkretisht për çfarë kanë ndihmuar këto imazhe kryesisht? Për çfarë janë përdorur më së shumti satelitët? Nga monitorimi i territorit me satelitë çfarë fenomenesh janë parandaluar? Në pritje të një date për intervistën (për të qenë më konkretë duam që xhirimet t'i realizojmë në një nga sallat ku punohet me pamjet satelitore, normalisht pa cënuar elementet e sigurisë) Faleminderit!	24.01.2025	Përsëndetje Znj. H, Faleminderit për interesimin tuaj lidhur me përdorimin e satelitëve "Albania 1" dhe "Albania 2" në monitorimin dhe menaxhimin e territorit. Ky është një fushë që ka një rëndësi të veçantë për Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) dhe të gjitha institucionet përfshirëse, dhe do të ishte shumë e dobishme që të zhvillohet një takim për të diskutuar në mënyrë më të detajuar përdorimin e imazheve satelitore dhe analizimin e të dhënave për menaxhimin e fatkeqësive dhe emergjencave civile. 1. Sa imazhe janë prodhuar dhe konkretisht për çfarë kanë ndihmuar këto imazhe kryesisht? Që prej lëshimit të satelitëve "Albania 1" dhe "Albania 2", deri më 31.12.2024 janë prodhuar 1059 imazhe satelitore. Këto imazhe kanë ndihmuar kryesisht në monitorimin e territorit dhe identifikimin e fenomeneve natyrore si zjarret,	Znj. E plote	Nuk ka
---	------------	---	------------	--	--------------	--------

			përmbytjet dhe rrëshqitjet e dheut. Disa përdorime specifike përfshijnë: Monitorimin e zonave të rrezikuara nga përmbytjet dhe zjarret. Zbulimin e ndërtimeve pa leje dhe ndotjes mjedisore. Analizimin e resurseve natyrore si pyjet dhe uji, si dhe mbështetje për strategjitë e mbrojtjes civile. Institucionet që kanë përdorur informacionet e përftuara nga imazhet satelitore përfshijnë: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Agjencia Menaxhimit të Burimeve Ujore Agjencia Kombëtare Mjedisit Agjencia Kombëtare e Pyjeve Agjencia Kombëtare e Bregdetit Drejtoria e	
--	--	--	---	--

			Përgjithshme e Gjendjes Civile Instituti i Statistikave 2. Për çfarë janë përdorur më së shumti satelitët? Satelitët janë përdorur kryesisht për: Menaxhimin e emergjencave, duke siguruar informacion të shpejtë për vlerësimin e dëmeve dhe reagimin në situata emergjente. Menaxhimin e burimeve ujore, duke monitoruar burimet dhe mundësuar analizat për ruajtjen e tyre. Bujqësi, për analizimin e kushteve të tokës dhe monitorimin e kulturave bujqësore. Planifikimi urban, për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm dhe identifikimin e zonave problematike. 3. Nga monitorimi i territorit me satelitë, çfarë fenomenesh janë parandaluar? Përmes monitorimit të territorit me satelitë, janë parandaluar disa fenomene natyrore të rrezikshme, përfshirë zjarret, përmytjet, rrëshqitjet e	
--	--	--	---	--

				dheut etj; duke mundësuar vlerësimin e zonave me risk dhe krijimin e masave parandaluese në këtë zona, si dhe hartimin e strategjive për zvogëlimin e riskut natyror dhe përmirësimin e planifikimit të masave të mbrojtjes civile. Faleminderit.		
3						
4						